

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Nëntor, 2022

Zhvillohet në Bruksel takimi dypalësh KE-Shqipëri për kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

24-25.11.2022: Në kuadër të procesit të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, u zhvillua në Bruksel takimi dypalësh mes Komisionit Europian dhe Shqipërisë mbi shqyrtimin analitik të kapitullit 23: "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore". Delegacioni shqiptar kryesohej nga Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator Znj.Dhuka, negociatori i kapitullit 23, zëvendësministri i Drejtësisë, znj.Pirdeni dhe drejtues e përfaqësues të lartë të institucioneve të drejtësisë, dhe të autoriteteve publike që sigurojnë zbatimin e të drejtave të njeriut. Institucionet shqiptare, prezantuan përpara Komisionit Europian shkallën e deritanishme të përafritimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE, kapacitetet administrative institucionale, zbatimin praktik të legjislacionit si dhe planet e ardhshme të fushës. Takimi dypalësh u shoqërua me dhënie informacioni të shtuar në përgjigje të pyetjeve të bëra nga BE, gjithashtu. Për disa prej pyetjeve po përgatitet informacioni me shkrim, për tu përmbyllur kjo fazë e procesit me raportin e kapitullit që do të adresohet qeverisë shqiptare.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://www.facebook.com/drejtësia.gov.al/posts/>



GRECO vlerëson Shqipërinë për transparencën e funksionarëve publikë, politikën e integritetit, deklarinë dhe pasurive dhe SPAK

28.11.-2.12.2022: Në seancën plenare të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit, GRECO, të Këshillit të Evropës, u morr në shqyrtim raporti i vlerësimit për Shqipërinë në zbatim të 24 rekomandimeve të dhëna vendit në kuadër të Raundit V të Vlerësimit: Parandalimi i korrupsionit dhe promovimi i integritetit në qeverisjen qendrore (funksionarët e nivelit të lartë) dhe agjencitë ligjzbatuese. Raporti i qeverisë shqiptare i dorëzuar në 30 prill 2022, dhe informacionet shtesë të dhëna në vijim si edhe ato në seancë plenare, u morën në shqyrtim nga sekretariati i GRECO dhe ekspertët reporterë të dy vendeve, të Greqisë dhe të Hungarisë. Nga vlerësimi i bërë, Shqipëria u vlerësua shumë mirë për transparencën e shtuar të autoriteteve publike, për informimin e stafeve dhe funksionarëve të lartë politikë dhe të informacioneve të tyre; për vendosjen e planeve të integritetit në institucionet qendrore të administratës dhe zbatimin e tij në strukturat e policisë së shtetit; për sigurimin e deklarinë online të pasurive dhe interesave të zyrtarëve publike si dhe të kapaciteteve administrative për kontrollin e tyre; për rritjen dhe kapacitetet profesionale të SPAK. Vlerësim të mirë morën çështje si parashikimi dhe vendosja e mekanizmave kontrollues të funksionarëve politike (ministra dhe këshilltarë të tyre), nivelet e shtuara të konsultimit publik të akteve, dhe ndërgjegjësimi i rritur mbi korrupsionin dhe integritetin i funksionarëve politikë dhe në strukturat e policisë, apo aplikimi i shtuar i instrumentit të sinjalizuesve në këto sektorë. Çështje si mbajtja në kontroll dhe garanci të shtuara për qëndrueshmëri në detyrë të drejtuesve të lartë të policisë apo rregulla për pas-punësimin në detyrë të funksionarëve politike dhe atyre në polici mbeten ende për zbatim dhe raportim të shtuar në GRECO. Shqipëria do të dorëzojë në GRECO informacione të shtuara jo më vonë se 30 qershor 2024.



Sekretariati teknik antikorrupsion finalizon raportin e monitorimit të Planit të Veprimit, korrik - shtator 2022

1-30.11.2022: Sekretariati Teknik pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka përfunduar dhe hartuar raportin e monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit Antikorrupsion, për periudhën korrik - shtator 2022. Ky raport monitorimi jep një informacion mbi progresin për 58 masa dhe 108 aktivitete të planifikuara për zbatim për këtë periudhë të vitit, në fusha të parandalimit – ndëshkimit – ndërgjegjësimit kundër korrupsionit. Nga monitorimi i kryer rezultojnë se janë zbatuar plotësisht 25 masa/51 aktivitete, pjesërisht 16 masa/12 aktivitete dhe nuk janë zbatuar 16 masa/38 aktivitete. Shërbimet elektronike vijnë të jenë me zbatueshmëri mjaft të mirë, 1 225 në total, dhe tejkaluar numrin kundrejt parashikimit në planin e veprimit, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vijon dhe garanton dhënie informacioni për publikun nëpërmjet koordinatorëve të të drejtës së informimit, Policia e Shtetit, ka ndërvëpruar 452 praktika me Interpolin, 939 praktika me Europolin, 96 praktika me Departamentin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe 23 praktika me rrjetin CARIN; ka 7 procedime penale të finalizuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore. Draft-raporti final i monitorimit do të dakordësohet me institucionet zbatuese të Planit të Veprimit Antikorrupsion në dhjetor, dhe drafti final do të diskutohet dhe miratohet në takimin e Grupit Tematik Antikorrupsion.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://drejtësia.gov.al/viti-2022-2/>



Objektivi	Indikator	Objektivi	Indikator	Objektivi	Indikator
A1	100%	E1	100%	C1	100%
A2	100%	E2	100%	C2	100%
A3	100%	E3	100%	C3	100%
A4	100%	E4	100%	C4	100%
A5	100%	E5	100%	C5	100%
A6	100%	E6	100%	C6	100%
A7	100%	E7	100%	C7	100%
A8	100%	E8	100%	C8	100%
A9	100%	E9	100%	C9	100%
A10	100%	E10	100%	C10	100%
A11	100%	E11	100%	C11	100%
A12	100%	E12	100%	C12	100%
A13	100%	E13	100%	C13	100%
A14	100%	E14	100%	C14	100%
A15	100%	E15	100%	C15	100%
A16	100%	E16	100%	C16	100%
A17	100%	E17	100%	C17	100%
A18	100%	E18	100%	C18	100%
A19	100%	E19	100%	C19	100%
A20	100%	E20	100%	C20	100%

Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion vijon hetimin administrativ të rasteve të dyshuara të korrupsionit

1-30.11.2022 Drejtoria e Monitorimit të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion dhe Drejtoria Operacionale për Çështjet Antikorrupsion pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka vijuar në mënyrë aktive hetimin dhe verifikimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit. Përgjatë muajit nëntor, është kryer një proces i hollësishëm i hetimit administrativ mbi rastet e denoncuar, në përfundim të të cilave, janë hartuar raporte përfundimtare hetimi për nëpunësit/punonjësit e institucioneve, subjekt hetimi të gjetur në shkelje. Konkretisht gjatë këtij muaji, është proceduar me raporte përfundimtare të hetimit administrativ për Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier, Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamëz-Vorë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për të cilët janë evidentuar personat përgjegjës të gjetur në shkelje, si dhe janë lënë rekomandime për institucionin me qëllim ndërmarrjen e masave përkatëse. Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit synon që përmes mekanizmit të rekomandimeve, të sigurohet për respektimin e zbatimit të ligjit dhe përmirësimin e veprimtarisë dhe punës së organeve publike në vend. Kushdo që ka indicie dhe dyshime të arsyeshme për raste korrupsionin në organet e administratës publike mund t'i drejtohet lehtësisht strukturave përgjegjëse në ministri dhe/apo pranë Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion.

Ankesa/denoncime mund të dërgohen direkt në email: koordinatoriak@drejtësia.gov.al

Grupi Drejtues i RAI konfirmon angazhimin në projekte rajonale antikorrupsioni

21-22.11.2022: Ministria e Drejtësisë në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit mori pjesë në takimin e 38-të të Grupit Drejtues të Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), në Bukuresht, Rumani. Ky takim u organizua nga Sekretariati i RAI-t dhe kësaj here mikpritës i takimit ishte Ministria e Drejtësisë e Rumanisë. Grupi Drejtues, i përbërë nga përfaqësues anëtarë të vendeve të Ballkanit Përqendror, por edhe vende të rajonit si Rumani, Bullgaria, Kroacia dhe Moldavia, diskutoi dhe vendosi për çështje të rëndësishme, siç përmenden: prezantimi i raportit të vlerësimit të punës, 2021-2022, miratimi i planit të punës për RAI për 2023-2025, zgjatja e mandatit të drejtuesit dhe të kreut të sekretariatit teknik, miratimi i buxhetit vjetor dhe



konfirmimin e shpalljes në muajin janar 2023, të pozicionit të këshilltarit të lartë për antikorrupsionin. Ministria e Drejtësisë e Shqipërisë paraqiti për anëtarët e Grupit Drejtues, disa nga zhvillimet dhe projektet më të rëndësishme të periudhës prill - nëntor 2022 si dhe arritjet kryesore në fushën e programeve dhe projekteve antikorrupsion. RAI do të vijojë të organizojë bashkëpunime programesh dhe aktiviteteve në luftën kundër korrupsionit, me fokus forcimin e kapaciteteve të shteteve të rajonit për të bashkuar përpjekjet në këtë sfidë të përbashkët dhe për të arritur rezultate të reja si partnerë, në nivel rajonal.



Më shumë të dhëna mund të gjeni në link: <https://www.facebook.com/raiseeorg/posts/515282427305581>

Vendet e Ballkanit Perëndimor bashkë për të vijuar bashkëpunimin për Udhërrëfyesin Rajonal Kundër Korrupsionit dhe Financave të Paligjshme

13-14.11.2022: 6 vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Kosovë dhe Serbi vijuan takimet rajonale nën koordinimin e UNODC dhe RAI, për të dakordësuar vijueshmërinë e angazhimeve të tyre në kuadër të dokumentit: Udhërrëfyesi Rajonal Kundër korrupsionit dhe Financave të Paligjshme për Ballkanin Perëndimor. Takimi u zhvillua në Lubjanë, Slloveni. Për dy ditë, delegacionet e shteteve të vendeve të rajonit, së bashku me përfaqësues të shoqërisë civile, diskutuan mbi përmbajtjen e udhërrëfyesit dhe shtjelluan më tej konkluzionet e paraqitura nga takimet pararendëse. Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë udhëhoqi delegacionin shqiptar të përbërë nga përfaqësues nga Kryeministria, Ministria e Brendshme, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe Agjencia e Prokurimit Publik. Udhëzuesi Rajonal Kundër korrupsionit dhe Financave të Paligjshme, do të vijojë të jetë i orientuar dhe do të përmbajë angazhime për vendet në fushën e prokurimit publik (kuadër ligjor dhe forcim kapacitetesh), deklarin e pasurive të zyrtarëve publikë dhe bashkëpunimin rajonal në fushën e hetimeve penale të krimit ekonomik dhe financiar. Udhëzuesi do të rikonfirmohet nga drejtues politikë dhe funksionarë të lartë në një konferencë që do të mbahet në muajin dhjetor në Shkup, Maqedoni.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: <https://www.facebook.com/raiseeorg/posts/521692566664567>

Rekuperimi i aseteve dhe bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar tematikë diskutimi në punimet plenare të UNCAC

7-11.11.2022: Punimet plenare të grupeve të përbashkëta të punës së Konventës së OKB për rikuperimin e aseteve (takimi i 16-të), bashkëpunimin ndërkombëtar (takimi i 11-të) dhe rishikimin e zbatimit të Konventës (takimi i grupit të 2-të të seancës së 13-të) u zhvilluan në Vienë, Austri. Përfaqësues të institucioneve shqiptare të fushës së drejtësisë, të antikorrupsionit, të prokurimit publik dhe të deklarin të pasurive ndoqën këto takime dhe informuan për zhvillimet e vendit në këto sektorë. Gjatë punimeve, u zhvillua edhe një takim i posaçëm (*side event*), për organizimin dhe funksionimin e Zyrave të Rekuperimit të Aseteve në Ballkanin Perëndimor. Në këtë takim, vendet e Ballkanit Perëndimor ndanë praktikën dhe eksperiencat e tyre të fushës së rekuperimit të aseteve. Shqipëria bëri një prezantim gjeneral mbi statusin e ngritjes së kësaj Zyre, në vend, pritshmëritë dhe ndërhyrjet e mundshme institucionale. Gjithashtu, një takim bilateral pune u zhvillua me sekretariatit e UNODC për mekanizmin e rishikimit të Konventës së OKB-së kundër Korrupsionit, në të cilën u informua se së shpejti do të përcillet draft-raporti për Shqipërinë pasvlerësimit të bërë nga Liberia dhe Azerbajxhani, për zbatimin e kapitullit 2 dhe 5 të Konventës së OKB (organizimi i kuadrit rregullator, institucional e strukturor). Në vijim do të pregatitet edhe vizita e ekspertëve vlerësues në vend.

